

DRAFT PAKTI PËR UNIVERSITETIN



KAPITULLI I. NË PËRGGJIGJE TË 8 KËRKESAVE TË STUDENTËVE..... 2

- 1 Rritja e Buxhetit të Arsimit në 5% të GDP, me qëllim mundësimin e përgjysimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës (universitete dhe konvikte)3
 - 2 Transparencë me buxhetin nga Ministria e Arsimit dhe IAL-të, publikimi të gjitha shpenzimeve online..... 10
 - 3 Rritja nga 10% në 50% e peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur kandidatët për dekanë, rektorë dhe çdo fakultet të ketë një përfaqësues të studentëve në Senatin Akademik..... 12
 - 4 Rishikimi i titujve akademikë dhe verifikimi i plagjiaturave të doktoraturave dhe teksteve mësimore..... 14
 - 5 Mbështetur në nenin 99 mbi Këshillat Studentore, ligji i Arsimit të Lartë, pika 2, kërkojmë që Bordi i Administrimit të IAL-eve të ketë numër të barabartë votash si nga MASR dhe IAL-të, si edhe të shtohet një përfaqësues në këtë Bord nga studentët..... 16
 - 6 Pajisja e të gjithë studentëve me Kartën e Studentit brenda vitit akademik 2018 - 2019..... 17
 - 7 Ndërtimi i bibliotekave me standarde europiane dhe me libër universitar online falas për studentët në gjuhën shqipe..... 18
 - 8 Vlerësimi i performancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor i pedagogut, publikimi i tij online dhe regjistrimi i leksioneve..... 19
- KAPITULLI II. POLITIKAT DHE MASAT E NDËRMARRA NË SHËRBIM TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË SË IAL-ve, 8 PIKAT PLUS.....21
- 9 Transparencë në Vendimmarrje dhe Integritet në Mësimdhënie.....22
 - 10 Politikat Financiare në Shërbim të Cilësisë së Kërkimit Shkencor dhe Konkurrueshmërisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare të IAL-ve.....24
 - 11 Punësimi i Studentëve.....25
 - 12 Stazhet dhe Praktikat Profesionale të Studentëve.....27
 - 13 Kampusi Universitar i Tiranës.....28

1

Rritja e Buxhetit të Arsimit në 5% të GDP, me qëllim mundësimin e përgjysmimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës (universitete dhe konvikte)


1.1

Reduktimi me 50% të tarifave

Situata aktuale

Kostoja për student në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), në varësi të programit dhe IAL-së, luhet nga më e ulëta 55,000 lekë në Universitetin e Durrësit deri në 470,000 lekë më e larta në Universitetin e Arteve në Tiranë. Kontributi i buxhetit të shtetit tek kjo kosto luhet nga 54% në IAL me kosto më të ulët, në 91% në koston më të lartë. Si rezultat, studenti paguan 25,000 lekë për programin me koston më të ulët deri në 45,000 lekë për programin me koston më të lartë. Buxheti i shtetit mbulon kostot:

- Në Universitetin e Tiranës, për 81% të studentëve, në masën 63%-74%;
- Në Universitetin e Mjekësisë, për 100% të studentëve, në masën 70%-77%;
- Në Universitetin Politeknik, për 90% të studentëve, në masën 61%-72%;
- Në Universitetin Bujqësor, për 100% të studentëve, në masën 69%-80%;
- Në Universitetin e Sporteve, për 100% të studentëve, në masën 83%;
- Në Universitetin "Aleksandër Mojsiu" në Durrës, në masën 54%;
- Në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, në masën 66%;
- Në Universitetin "Fan Noli" në Korçë, në masën 81%;
- Në Universitetin "Eqrem Cabej" në Gjirokastrë, në masën 90%;
- Në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, në masën 74%-80%;
- Në Universitetin "Ismail Qemali" në Vlorë, në masën 82%.




Për të adresuar kërkesat e studentëve, Këshilli i Ministrave ka miratuar:

- 1 Vendimin nr. 778, datë 26.12.2018, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”;
- 2 Vendimin nr. 779, datë 26.12.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar.
- 3 Vendimin nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për urlje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë”.
- 4 Vendimin nr. 784, datë 26.12.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave nga Fondi i Mbështetjes Studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar.

Përkrahja

- 1 Referuar VKM nr. 778 të sipërcituar, parashikohet që:
 - a) Kufiri maksimal i tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë, për vitin akademik 2018-2019 dhe në vijim, paguhet nga studentët në masën 50% të vlerave të pasqyruara në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”. Institucionet publike të Arsimit të Lartë rimburohen me fonde grant nga buxheti i shtetit për vlerën e tarifës vjetore të reduktuar, sa me sipër”.
 - b) Studentët, të cilët rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik, nga viti akademik 2019-2020 e në vijim, paguajnë tarifën e plotë të studimit, të pasqyruar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet vendimit të sipërcituar.

Shënim: Paketa e akteve nënligjore për uljen e tarifave të studimit është në proces përmirësimi, me synim adresimin e të gjitha problematikave të ngritura nga studentët.



Ekselenca

2

a)

b)

Referuar VKM nr. 779 të sipërcituar, përjashtohen nga tarifa vjetore:

Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë).

Studentët e pranuar në vitin e parë akademik në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm.

Përkrahja

3

Referuar VKM nr. 780 të sipërcituar, parashikohet që:

Për të përkrahur studentët që ndjekin studimet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas kategorive të mëposhtme, do të paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve, të miratuar nga Institucionet publike të Arsimit të Lartë, këta studentë:

a)

Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët, fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCAP-së, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e qeverisjes vendore;

**11 VKM DHE 4 URDHËRA
TË KRYEMINISTRIT SOT
ULJA E TARIFAVE**

**NIVELI I STUDIMEVE MASTER: PËRGJYSMIM ME
50% TË TARIFËS PËR:**

- STUDENTËT ME NOTË MESATARE MBI 9 NË HYRJE,
- STUDENTËT NGA FAMILJE NË NDIHMË EKONOMIKE,
- TË VERBRIT, STUDENTËT PARAPLEGJIKË E TETRAPLEGJIKË,
- JETIMËT, FËMIJËT E POLICËVE TË RËNË NË KRYE TË DETYRËS.

- b) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të qeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;
- c) Studentët që kanë përfitur statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;
- d) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;
- e) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfitur statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore;
- f) Studentët, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;
- g) Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;
- h) Studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist, ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- i) Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në Institucionet publike të Arsimit të Lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në Institucionet publike të Arsimit të Lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë);
- j) Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike, të parashikuara për vitin akademik paraardhës.

Studentët, sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e mësipërme, do të paguajnë tarifën vjetore të studimeve në masën 50%, pas paraqitjes së dokumentacionit vërtetues për statusin e tyre ligjor, me vendim të Bordit të Administrimit të Institucionit publik të Arsimit të Lartë.

Më pas është Bordi i Administrimit të Institucionit që shqyrton dhe miraton për çdo vit akademik, jo më vonë se muaji dhjetor, listën e studentëve të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret si më lart.

Vendimi i Bordit të Administrimit të Institucionit publik të Arsimit të Lartë i njoftohet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

Institucionet publike të Arsimit të Lartë do të rimbursohen me fonde grant nga buxheti i shtetit për vlerën e tarifës vjetore të reduktuar sa më sipër.

- 4
- a) Referuar VKM nr. 784 të sipërcituar:
Përfitojnë bursë, në masën e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, studentët e pranuar në vitin e parë akademik, për çdo program studimi në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, me notë mesatare vjetore mbi 9 (nëntë) nga sistemi i arsimit të mesëm, të përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare do të hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe do dërgohet në Institucionet publike të Arsimit të Lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- b) Studentët e regjistruar në çdo program studimi, në vitet pas të parit, me kriterin e notës mesatare mbi 9 (nëntë), të përlogaritur nga Institucionet e Arsimit të Lartë, vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT ULJA E TARIFAVE

NIVELI I STUDIMEVE BACHELOR. HEQJE TOTALE
E TARIFËS + BURSË 10.000 L NË MUAJ PËR:

- STUDENTËT E FAMILJEVE NË NDIHMË EKONOMIKE
- TË VERBRIT, STUDENTËT PARAPLEGJIKË E TETRAPLEGJIKË
- STUDENTËT ME NOTË MESATARE MBI 9, NË ÇDO PROGRAM STUDIMI.

PËRGJYSMIM ME 50% TË TARIFËS SË REGJISTRIMIT
PËR GJITHË STUDENTËT.

Ndërkohë, referuar vendimit nr. 269, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët, të cilët janë pranuar në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, të kategorive të mëposhtme:

- a) Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCAP-së, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e qeverisjes vendore;
- b) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen /përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të qeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;
- c) Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;
- d) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;

- e) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore;
- f) Studentët, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga Ministria përgjegjëse për Punët e Brendshme dhe ajo e Mbrojtjes;
- g) Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;
- h) Studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist, ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

1.2

SISTEMI I KONVIKTEVE NË ARSIMIN E LARTË PUBLIK

Situata aktuale

Aktualisht, funksionojnë 8 shoqëri për akomodimin e studentëve (shoqëritë e trajtimit të studentëve), 3 prej të cilave janë në Tiranë dhe 5 të tjera në Vlorë, Shkodër, Elbasan, Gjirokastër dhe Korçë. Në to janë të punësuar 778 punonjës administrativë dhe shërbimesh.

Numri total i studentëve të akomoduar në këto ndërmarrje studentore për vitin 2018 është 7,213 studentë, ose 11% e numrit total të studentëve.

Shoqëritë e trajtimit të studenteve janë të organizuara në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Këto shoqëri janë me kapital 100% shtetëror, me pronar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me përjashtim të rezidencave studentore nr. 1, 2, dhe 3, të cilat janë transferuar në masën 100% të aksioneve tek Bashkia Tiranë, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 04.05.2016, me të gjithë të drejtat dhe detyrimet, që nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Shoqëritë e tjera, në Shkodër, Vlorë, Gjirokastër, Korçë dhe Elbasan, janë në administrim të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe marrin mbështetje financiare nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Të gjithë shoqëritë marrin fonde grant për mbështetje financiare nga MASR, për të mbuluar rreth 50% të shpenzimeve të tyre, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve mbulohet nga të ardhurat nga tarifat e studentëve.

Administrimi financiar i tyre kryhet përmes Këshillave Mbikëqyrës, ku përfaqësues në shumicë janë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe një përfaqësues nga MASR.

Fondi që MASR ka në dispozicion, për të mbuluar shpenzimet operative për këto ndërmarrje, është 350 milionë lekë në vit, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga të ardhurat e vetë ndërmarrjeve.

Fonde për shpenzime kapitale për rikonstruksionin e tyre nuk janë dhënë asnjëherë nga MASR, për shkak të natyrës ligjore të funksionimit të tyre (organizohen në bazë të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

Fondet për shpenzime korrente në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve transferohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë, bazuar në:

- Vendimin nr. 75 datë 12.02.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të IAL-ve”;
- Udhëzimin nr. 7 datë 24.04.2003 “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve e mensave”;
- Udhëzimit Nr. 394, datë 21.8.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”.

Problematikat

Gjendja financiare dhe e infrastrukturës së NTS-ve është problematike. Mbështetja nga buxheti i shtetit në shumën 350 milionë lekë duhet të rishikohet, pasi është në masë të ulët dhe i referohet çmimeve të përcaktuara me udhëzimin e vitit 2003.

- 78.2% të shpenzimeve totale të shoqërive e zënë shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore), si dhe shpenzimet për energji elektrike dhe ujë;
- 1.3% të shpenzimeve e zënë pagesat për ruajtjen e ambienteve me polici private;
- 1% janë pagesat për Këshillat e Administrimit dhe pjesa tjetër për shërbime të tjera.

Gjendja e infrastrukturës është tejte e amortizuar pothuajse në të gjitha ndërtesat në rrethe. Edhe në Tiranë, me përjashtim të ndërtesave ku po ndërhyhet me projektin e KfW-së, financuar nga Qeveria Gjermane, të gjithë ndërtesat e tjera kanë nevojë për rehabilitim, pajisjen me mobilie, shtretër, bazë materiale, dyshekë e çarçafë të rinj. Për shkak të gjendjes së amortizuar të këtyre ndërtesave, aktualisht akomodohen gjithsej 7,213 studentë, ndërsa kapaciteti maksimal i tyre është rreth 14,000 studentë.

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT SISTEMI I KONVIKTEVE NË ARSIMIN E LARTË PUBLIK

NË AKTIN NORMATIV TË BUXHETIT 2018 JANË
PARASHIKUAR RRETH 300 MILIONË LEKË SHITESË PËR
KRYERJEN E INVESTIMEVE NË INFRASTRUKTURËN E
KONVIKTEVE PËR VITIN 2019.

NËPËRMJET BASHKËPUNIMIT ME QEVERINË GJERMANE
DHE KFW DO TË FINANCOHET RIKONSTRUKSIONI TOTAL
I REZIDENCAVE STUDENTORE NË NJË INVESTIM TOTAL
PREJ 27 MILIONË EURO. DUKE NISUR NGA MARS 2019.

Vlerësohet se baza ligjore për ndërmarrjet e trajtimit të studentëve ka nevojë të rishikohet, pasi udhëzimet janë të një periudhe shumë të hershme, nuk pasqyrojnë dhe nuk reflektojnë situatën aktuale që lidhet me ndryshimet që kanë pësuar çmimet e mallrave dhe shërbimeve bazë që i nevojiten këtyre shoqërive.

Mbështetur në bazën ligjore të lartpërmendur, këto shoqëri janë të organizuara si shoqëri aksionere (SH.A) me kapital 100% shtetëror. Për këtë arsye nuk është bërë e mundur ndërhyrja nga shteti me investime kapitale (vetëm Ministri i Ekonomisë dhe Financave, në cilësinë e pronarit të tyre mund të lejojë ndërhyrjen me investime kapitale, si pronar i aseteve të tyre dhe zotërues 100% i tyre.

Në këtë situatë, propozojmë:

1. Ndryshimin e Udhëzimit Nr. 7, datë 24.04.2003 "Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në ndërmarrjet e trajtimit të studentëve dhe ndërmarrjet e konvikteve e mensave".
2. Për ndërhyrjet në infrastrukturën fizike të NTS-ve, propozojmë të trajtohen me të njëjtën skemë sikurse trajtohet infrastruktura e arsimit parauniversitar dhe arsimit të lartë, pra, të përfshihen në Aneksin 3 të ligjit vjetor të Buxhetit edhe godinat e NTS-ve, për të përfituar financime nga buxheti i MASR.
3. Të rishikohet VKM nr. 75, datë 12.02.2018, "Për miratimin e modelit të financimit të IAL-ve", duke ndryshuar pikën 2 të seksionit 5 "Dispozita kalimtare" dhe të rikonceptohet një VKM e dedikuar për shoqëritë me kapital aksionar për funksionimin e NTS-ve.

Janë parashikuar rreth 300 milionë lekë shitesë për kryerjen e investimeve në infrastrukturën e konvikteve për vitin 2019;

Me investimet e reja, që po kryhen me financimin e KfW, përveç përmirësimit të kushteve të konvikteve, kapaciteti akomodues mund të ulet me 12 mijë studente, ose të rritet në 15 mijë studentë, në varësi të standardeve hapësinore për student që do të përcaktohen.

Nëpërmjet financimit prej 16.8 milionë euro nga Qeveria Gjermane do të mundësohet rehabilitimi i një numri maksimal prej 13 ndërtesash të rezidencave studentore universitare në Tiranë (nga 37 ndërtesa që përllogariten të jenë në total në qytetin e Tiranës, ku 29 ndërtesa janë në QSU1 dhe 8 në QSU2), duke synuar përmirësimin e kushteve të jetesës së rreth 2,900 studentëve.

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë është duke negociuar me KfW për të vijuar rehabilitimin e banesave studentore, për një projekt me vlerë 27 milionë euro, nga të cilat 7 milionë euro grant dhe 20 milionë euro kredi.

Afati i realizimit

- Ndryshimi i akteve nënligjore - brenda muajit mars 2018 (Shiko edhe pikat 8 Plus).
- Ndërhyrje për rikonstruksione, me financimin nga Buxheti i Shtetit 2019-2021 - brenda një periudhe 3-vjeçare.

2

TRANSPARENÇË ME BUXHETIN NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE IAL-VE, PUBLIKIMI TË GJITHA SHPENZIMEVE ONLINE

Situata aktuale

Institucionet publike të Arsimit të Lartë gëzojnë të drejtën:

- Për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;
- Për të përcaktuar tarifat e studimit në përputhje me këtë ligj;
- Për të përfutur fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;
- Për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucionet zotërojnë ligjërisht, në përputhje me misionin e tyre.

IAL-të i hartojnë vetë buxhetet e tyre, duke filluar nga niveli i çdo departamenti, në nivel fakulteti e më pas buxhetet konsolidohen në nivel IAL-je. Buxheti miratohet paraprakisht nga Senati Akademik dhe më pas i kalohet për aprovim final Bordit të Administrimit.

Buxheti i miratuar administrohet nga Administratori i IAL-së, në përputhje me zërat e aprovuar dhe sipas ligjeve për shpenzimet publike.

Studentët, por edhe një pjesë e madhe e stafëve pedagogjike, kanë informacion të limituar mbi buxhetin, si në nivelin e hartimit dhe aprovimit të tij, si edhe të shpenzimeve që kryhen nga çdo Institucion i Arsimit të Lartë.

ZGJIDHJA

Për të adresuar problematikën e ngritur nga studentët dhe stafet pedagogjike, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 781, datë 26.12.208 "Për garantimin e transparencës në Institucionet publike të Arsimit të Lartë".

Ky vendim ka për qëllim garantimin e transparencës në Institucionet publike të Arsimit të Lartë. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të bëjë publike të dhëna e informacione në kuadër të programit të transparencës dhe të trajtimit të ankesave ndaj Institucioneve të Arsimit të Lartë, përmbajtja e të cilave do të publikohet në portalin e transparencës dhe të trajtimit të ankesave.

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT
TRANSPARENÇA

NGRIHET PORTALI I TRANSPARENÇËS DHE ANKESAVE PËR IAL-TË.

PUBLIKIM ONLINE I:

- TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE TË UNIVERSITETEVE
- VENDIMEVE TË BORDIT, TË SENATIT DHE ORGANEVE TË TJERA
- NGRIHET ZYRA PRANË MASR PËR TRANSPARENÇËN DHE ADRESIMIN E ANKESAVE

Portali do të jetë i aksesueshëm nga të gjithë dhe në do të publikohen online:

- a) të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të çdo Institucioni të Arsimit të Lartë, sipas formatit të miratuar me Urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për Arsimin dhe ministrit përgjegjës për Financat. Duke filluar nga viti buxhetor 2019, Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë, nëpërmjet administratorit, të përcjellë çdo tre muaj, për publikim, pranë portalit të transparencës të dhënat e detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare, sipas përcaktimit të kësaj shkronje;
- b) të dhëna për Buxhetin Afatmesëm (PBA), buxhetin vjetor, grantin nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e tjera, të gjitha shpenzimet operative, shpenzimet për kërkim shkencor dhe shpenzimet kapitale të çdo Institucioni publik të Arsimit të Lartë;
- c) informacion për procedurat e prokurimit publik (parashikim/realizim), apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat;
- d) vendimet e Bordit, të Senatit dhe organeve të tjera drejtuese/ vendimmarrëse;
- e) kuotat e parashikuara për çdo vit akademik;
- f) instrumentet dhe programet e shkëmbimit studentor dhe procedurat përkatëse;
- g) instrumentet e financimit të studimeve dhe procedurat përkatëse (bursat publike dhe ato specifike për çdo IAL);
- h) marrëveshjet dy- apo shumëpalëshe në nivel IAL-je apo institucione të tjera;
- i) të dhënat për bursat dhe stimujt financiarë të ofruar nga shteti për studentët;
- j) CV-të e pedagogëve;
- k) rezultatet e kontrollit dhe të verifikimit të titujve shkencorë;
- l) mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe paraqitjen e ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e drejtuesve/ organeve drejtuese të Institucioneve të Arsimit të Lartë, procedurën, nëpërmjet së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre, apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike, apo ushtrimin e funksioneve të Institucionit të Arsimit të Lartë.

Publikimi online i të dhënave e informacioneve të mësipërme do të përditësohet në mënyrë periodike.

Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e strukturës përgjegjëse për kontrollin e transparencës në Arsimin e Lartë do të miratohen me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda muajit Shkurt 2019.

3

RRITJA NGA 10% NË 50% E PESHËS TOTALE TË VOTËS SË STUDENTËVE PËR TË ZGJEDHUR KANDIDATËT PËR DEKANË, REKTORË DHE ÇDO FAKULTET TË KETË NJË PËRFAQËSUES TË STUDENTËVE NË SENATIN AKADEMIK.

Situata aktuale

Ligji për Arsimin e Lartë e organizon pjesëmarrjen e studentëve nëpërmjet katër elementëve:

1) Pjesëmarrja në Senat

Senati është organi kolegjal më i lartë akademik i Institucionit të Arsimit të Lartë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij. Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik në masën 10% (dhjetë për qind).

2) Pjesëmarrja në Zgjedhje

Studentët marrin pjesë në zgjedhjet për Rektor dhe Dekan. Votat e studentëve në përzgjedhjen e Rektorit dhe Dekanit llogariten në masën 10% (dhjetë për qind) të totalit të përgjithshëm të votave.

3) Pjesëmarrja në Komisionet e Përhershme

Ligji u njuh të drejtën studentëve të përfaqësohen në të gjitha komisionet e përhershme. Komisionet e përhershme janë organe kolegjiiale, që organizohen në nivel Universiteti dhe në nivel Fakulteti. Ato kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut, të cilat lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e institucionit.

4) Këshillat Studentorë

Ligji u njuh studentëve të drejtën të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore, (fakultet) Institucioni të Arsimit të Lartë, si edhe në nivel kombëtar. Këshillat e studentëve promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Problematika

Në masën të madhe Këshillat Studentorë dhe Komisionet e Përhershme nuk janë ngritur. Këto institucione janë konceptuar për të qenë pika më e afërt e takimit dhe më e shpeshtë për problematikat e studentëve. Mungesa e tyre ka sjellë tek studentët ndjesinë e nënpërfaqësimit dhe për rrjedhojë, kërkesën për rritje të përfaqësimit. Jo të gjithë vendet kanë zgjedhje për trupat qeverisës, ndaj një përqindje krahasuese është e vështirë të gjendet.

Sidoqoftë, përqindjet e shumicës së vendeve luhaten mes 10-20%.

PAKTI PËR UNIVERSITETIN

DRAFT

Gjermani	<15%
Ukrainë	10%
Rumani	25%
Portugali	15%
Greqi	10%
Lituani	20%
Suedi	Pjesëmarrja sipas statutit të universitetit

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT ZGJEDHJET

GRUP NDËRINSTITUCIONAL PUNE PËR STATUTIN E IAL-VE.
ZGJEDHJET E KËSHILLAVE STUDENTORË DHE KOMIS-
IONEVE TË PËRHERSHME.

ZGJIDHJA

1. Hapja e zgjedhjeve për Këshillat Studentorë.
2. Monitorimi i Komisioneve të Përherëshme dhe përfaqësimi në të i studentëve në përputhje me statutin.

Afati i realizimit

- Qershor 2019

4

RISHIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË DHE VERIFIKIMI I PLAGJIATURAVE TË DOKTORATURAVE DHE TEKSTEVE MËSIMORE

Situata aktuale

Nga viti 2007 deri në vitin 2018, në regjistrin e MASR gjenden vetëm këto të dhëna në lidhje me gradat shkencore dhe titujt akademikë:

- 248 Docent;
- 3,757 Grada Shkencore “Doktor” brenda vendit;
- 546 Grada Shkencore “Doktor” jashtë vendit;
- 1,038 Tituj Akademikë “Profesor i Asociuar”;
- 2 Tituj Akademikë “Profesor i Asociuar” jashtë vendit;
- 503 Tituj Akademikë “Profesor”.

Problematika

Gjatë verifikimit të kriterëve të ligjshmërisë për të gjitha IAL-të në vend janë konstatuar problematikat si vijon:

- Vetëm në një institucion u gjetën një numer i lartë pedagogësh udhëheqës doktoraturash, nga të cilët një numer i madh nuk plotësonin kriteret ligjore;
- Mosrespektimi i standardit të udhëheqjes: 1 profesor jo më shumë se 5 doktorantë, duke kaluar në 1 profesor me 15 doktorantë mesatarisht. Madje u gjet 1 profesor me 41 doktorantë;
- Mosrespektimi i afateve kohore në marrjen e titullit. Ka IAL që kanë dhënë doktoratura edhe për tre muaj;
- Produktet e kërkimit nuk kanë gjetur zbatim në fushat përkatëse. Madje ka tema krejtësisht jashtë fushave, apo programeve ku janë dhënë.
- Prej disa vitesh, IAL nuk kanë marrë kuota për ciklin e tretë të studimeve

ZGJIDHJA

1. Është miratuar Vendimi nr. 777, datë 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave "Për kontrollin antiplagjaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore".

VKM për kontrollin antiplagjaturë të disertacioneve, ndër të tjera në të parashikon:

- Krijimin e arkivit digjital të doktoraturave në RSH pranë MASR;
- Ministria përgjegjëse për arsimin do të dorëzojë raportet e kontrollit digjital antiplagjaturë pranë IAL-ve respektive.

Afati i realizimit

Duke marrë në konsideratë proceset paraprake për sigurimin e software-it ,që do kryejë procesin e kontrollit antiplagjaturë të disertacioneve, pritet që ky kontroll të fillojë në muajin qershor 2019.

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT PLAGJIATURA

- KONTROLL ANTIPLAGJIATURË, RISHIKIM I TITUJVE AKADEMIKË.
- LIGJ I RI PËR KODIN E SJELLJES DHE INTEGRITET NË KËRKIMIN SHKENCOR.
- ARKIV DIGJITAL I DOKTORATURAVE PRANË MASR.

5

MBËSHTETUR NË NENIN 99 MBI KËSHILLAT STUDENTORE, LIGJI I ARSIMIT TË LARTË, PIKA 2, KËRKOJMË QË BORDI I ADMINISTRIMIT TË IAL-EVE TË KETË NUMËR TË BARABARTË VOTASH SI NGA MASR DHE IAL-TË, SI EDHE TË SHTOHET NJË PËRFAQËSUES NË KËTË BORD NGA STUDENTËT

Situata aktuale

Sipas Ligjit për Arsimin e lartë, Bordet e Administrimit përbëhen nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së.

Anëtarët përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për Arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore.

Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të Planit Buxhetor Afatmesëm të Institucionit publik të Arsimit të Lartë. Nëse institucioni siguron vetë pesëdhjetë për qind (50%), ose më shumë të buxhetit afatmesëm, katër prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe tre janë përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Në rastet kur institucioni siguron vetë më pak se pesëdhjetë për qind të buxhetit afatmesëm, tre prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe katër janë përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Sot, nga gjithë IAL-të publike, vetëm Universiteti i Tiranës ka një shumicë nga përfaqësues të Universitetit.

Bordet, megjithëse kanë përmirësuar ndjeshëm menaxhimin financiar të IAL-ve publike, nuk ia kanë dalë të ulin perceptimin e keqmenaxhimit financiar në IAL. Studentët kërkojnë përfaqësim në Bordin e IAL-ve.

ZGJIDHJA

Është miratuar Vendimi nr. 782, datë 26.12.2018 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë". Si rezultat i kësaj VKM-je dhe/ose akteve të tjera nënligjore, ndër të tjera parashikohet:

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT

BORDI

- SHKARKOHEN TË GJITHË ANËTARËT E BORDEVE TË EMËRUAR NGA MASR.
- EMËRIMET E REJA TË BËHEN ME VËMENDJE PUBLIKE.
- NJËRI PREJ ANËTARËVE TË BORDIT DO TË JETË PROPOZIM I STUDENTËVE.

5

- Shkarkimi i të gjithë anëtarëve të bordeve të emëruar nga MASR.
 - Emërimet e reja do të bëhen më një proces të hapur dhe me vëmendje publike;
 - Njëri prej anëtarëve që emërohet prej MASR, të vijë propozim nga studentët, por të jetë figurë publike në përputhje me ligjin, etj.;
2. Senatet ligjërish janë të lirë, që ndër vendet që ata kanë në Borde, të propozojnë një prej studentëve anëtar Senati, apo drejtues të Këshillit Studentor. Nëse kjo vendoset në Statutin e Universitetit, prezenca normohet definitivisht.

Afati i realizimit

- Prill-Maj 2019



6

PAJISJA E TË GJITHË STUDENTËVE ME KARTËN E STUDENTIT BRENDA VITIT AKADEMIK 2018 - 2019

Situata aktuale

Shqipëria nuk ka traditë në ofrim të favorizuar shërbimesh për studentët. Ndaj nga shkurti 2018 e në vazhdim ka pasur një sërë komunikimesh për këtë qëllim me Komisionin European, jo vetëm për përfshirjen e Shqipërisë në Kartën Europiane të Studentit, por dhe për të siguruar një asistencë të vazhdueshme nga pala franceze për këtë projekt.

Në nëntor 2018 është lidhur marrëveshja dypalëshe mes dy agjencive homologe, CNOUS dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me qëllim përgatitjen dhe implementimin e European Student Card në Shqipëri.

Problematika

- Procesi ka kërkuar kohë për t'u realizuar, pasi nevojitet përfshirja e institucione ve vendore, qendrore dhe biznesit.
- Mungesa e përvojës dhe kulturës për shërbime të favorizuara për studentët.
- Mungesa e gatishmërisë së institucioneve për të mundësuar shërbime të dedikuara.

ZGJIDHJA

1. MASR do të bëjë publike marrëveshjet e lidhura dhe listën e shërbimeve që përfitohen nga studentët me entet shtetërore, bashkitë dhe subjektet private.

2. Është hartuar draft-vendimi i Këshillit të Ministrave, që përcakton kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore, të cilat përfitohen përmes përdorimit të Kartës së Studentit, si një dokument unik me anë

të të cilit studentët përfitojnë çmime të reduktuara. Karta e Studentit pjesë e projektit të Kartës Europiane të Studentit dhe lëshohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Ky udhëzues pritet të përcaktojë shërbime me çmime të reduktuara për studentet në të gjithë vendin dhe për studentet e huaj në Shqipëri.

Afati

- Miratimi i 2 akteve nënligjore brenda shkurtit 2019.
- Lëshimi i Kartës për çdo student të regjistruar në vitin akademik 2019-2020.

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT KARTA E STUDENTIT

- BRENDA VITIT AKADEMIK 2018 - 2019, PAJISEN TË
GJITHË STUDENTËT.

7

NDËRTIMI I BIBLIOTEKAVE ME STARNDARDE EUROPIANE DHE ME LIBËR UNIVERSITAR ONLINE FALAS PËR STUDENTËT NË GJUHËN SHQIPE

Situata aktuale

Deri më sot, aksesit në librat dhe revistat shkencore ka qenë një veprimtari që lidhet drejtpërsëdrejti me vendimarrjen autonome të Institucioneve të Arsimit të Lartë. Rezulton se jo të gjithë Institucionet publike të Arsimit të Lartë kanë realizuar marrëveshje abonimi dhe për aksesueshmërinë në revista shkencore të lidhura me fushat përkatëse. Kjo situatë ka krijuar një boshllëk dhe mospërditësim me zhvillimet më të fundit shkencore. Në këtë kontekst, stafet pedagogjike dhe studentët hasin vështirësi për realizimin e objektivave universitare dhe përvetësimin e dijeve të nevojshme për zhvillimin e tyre

Problematika

- Mungesa e aksesit dhe mospërditësimi me zhvillimet më të fundit shkencore.
- Rritje të shpenzimeve të studentëve për blerjen e botimeve më të fundit shkencore për realizimin e detyrave të kursit.
- Mungesa e korrelacionit të drejtë me cilësinë dhe numrin cilësor të projekteve cilësore.

ZGJIDHJA

1. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ka kontaktuar Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), për të vlerësuar mundësinë e implementimit të bibliotekave elektronike. MASR do t'i akordojë një fond buxhetor të veçantë RASH, që ka ngritur grupin teknik për përgatitjen e ToR për infrastrukturën hardware dhe middleware, të nevojshme për ngritjen e bibliotekës digjitale. RASH po shqyrton modelet më të përshtatshme për t'u vënë në zbatim, si dhe ka marrë kontakt me ofruesit ndërkombëtarë të bibliotekave dhe të arkivave kërkimore në rang global.

2. Është miratuar Urdhrit nr.183, datë 26.12.2018 i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional për përzgjedhjen e literaturës së huaj që do të përkthehet, me qëllim përdorimin në Institucionet e Arsimit të Lartë". Në zbatim të këtij Urdhri, do të përditësohen dhe përmirësohen titujt akademikë të IAL-ve.

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT BIBLIOTEKAT

- BRENDA MUAJIT MARS, BIBLIOTEKA DIXHITALE NË DISPOZICION TË STUDENTËVE.
- KOMISION PËRCAKTIMI TË LITERATURËS AKADEMIKE NDËRKOMBËTARE, QË DO TË PËRKTHEHET NË SHQIP.

Afati i realizimit

Qershor 2019

8

VLERËSIMI I PERFORMANCËS NË MËSIMDHËNIE DHE KËRKIM SHKENCOR I PEDAGOGUT, PUBLIKIMI I TIJ ONLINE DHE REGJISTRIMI I LEKSIONEVE

Situata aktuale

Në arsimin e lartë shqiptar është vendosur një standard i ri, të gjitha universitetet janë akredituar ndërkombëtarisht nga Quality Assurance Agency (QAA), megjithatë, sikundër u cilësua dhe në raportin e akreditimit të QAA, disa institucione publike të arsimit të lartë nuk treguan seriozitetin e duhur në zhvillimin e procesit të akreditimit, kjo si pasojë e konflikteve të brendshme mes strukturave drejtuese, por edhe si rrjedhojë e mungesës së kulturës institucionale, të autoriteteve drejtuese të IAL-ve, në raportimin e veprimtarisë së tyre. Një tjetër hap i rëndësishëm në planin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe performancës në arsimin e lartë është miratimi i Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (11 shtator 2018), si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë, për programet e studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”, programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, “Master i Shkencave” dhe “Master i Arteve”, si dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë. Ky dokument unifikon dhe standardizon kriteret themelore të vlerësimit të cilësisë në institucionet universitare i paraprin procesit të vlerësimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL-të shqiptare, në kuadër të akreditimit të programeve, si hap pasues i akreditimit institucional, të realizuar me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm nga QAA.

Problematika

Studentët pretendojnë:

- Performancë jocilësore e personelit akademik;
- Kualifikime fiktive dhe aftësi minimale pedagogjike;
- Sistemi i rekrutimit dhe punësimit të pedagogëve shpesh kryhet në kushtet e anashkalimit të sistemit të meritës;
- Vlerësimet e performancës nuk realizohen efektivisht dhe objektivisht;
- Mbajtja jashtë e studentëve gjatë vlerësimit të performancës, duke ia lënë në dorë titullarëve të strukturave drejtuese, që në disa raste janë në konflikt interesi, apo kushte nepotizmi mes njëri-tjetrit;
- Kurikula universitare jo bashkëkohore, në masën më të madhe të paunifikuara dhe tekste të vjetra e jo cilësore.

8

ZGJIDHJA

1) Aplikimi i instrumentit të kontrolit dhe vlerësimit studentor të performancës së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të personelit akademik përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Duhet theksuar fakti që SKS nuk zëvendëson, apo mbivendoset me procesin e akreditimit, por ka një rol thelbësor në mbledhjen e informacioneve të nevojshme nga ana e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies.

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT PERFORMANCA

- HARTOJMË KODIN E CILËSISË DUKE PËRFSHIRË SHQETËSIMET E STUDENTËVE.
- ADRESIM I SHQETËSIMEVE STUDENTORE NË KODIN E CILËSISË SË ARSIMIT

Vlerësimi i cilësisë përmes SKS kryhet në mënyrë periodike (të vazhdueshme) dhe të dhënat e mbledhura prej tij shërbejnë për vlerësimin dhe orientimin e politikave të secilit institucion arsimor.

Bazuar në pikën 5 të nenit 104, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.783, datë 26.12.2018 “Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë, edhe nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve”.

Qëllimi i këtij vendimi është të sigurohet përmirësimi i cilësisë në procesin e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë e të garantohet vazhdimësia e nivelit të lartë të performancës së personelit akademik.

Institucioni përgjegjës për vlerësimin dhe monitorimin e performancës në mësimdhënie është Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), e cila, duke garantuar edhe pjesëmarrjen e përfaqësuesit të studentëve, duhet të monitorojë periodikisht ruajtjen e standardeve të cilësisë, si dhe të promovojë përmirësimin e cilësisë së Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit që ato ofrojnë.

Për të realizuar objektivat e saj, ASCAL fillimisht do të ngrejë grupet e punës që do të realizojnë procesin e vlerësimit të performancës në mësimdhënie të personelit akademik, duke siguruar që anëtarë të këtyre grupeve të punës të jenë edhe përfaqësuesit e studenteve, të propozuar nga institucionet e arsimit të lartë. Gjithashtu, ky institucion është përgjegjës edhe për hartimin e metodologjisë dhe instrumenteve të konkretizimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve, në përputhje me pikën 5 të nenit 104, të ligjit nr.80/2015.


Raportet e vlerësimit të përgatitura nga ASCAL do t’i paraqiten Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, krahas Institucionit të Arsimit të Lartë që i është nënshtruar procesit të vlerësimit, si dhe duhet të jenë pjesë e dosjes personale të çdo anëtari të personelit akademik.

Afati i realizimit

- Shkurt 2019 - Ngritja e grupeve të punës që do realizojnë procesin e vlerësimit.
- Mars 2019 - Hartimi i metodologjisë dhe instrumenteve të Sondazhit Kombëtar të Studentëve.
- Qershor 2019

PAKTI PËR UNIVERSITETIN

KAPITULLI II. POLITIKAT DHE MASAT E NDËRMARRA NË SHËRBIM TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË SË IAL-VE, PIKAT PLUS



9

TRANSPARENCË NË VENDIMMARRJE DHE INTEGRITET NË MËSIMDHËNIE

Situata aktuale

Ka mungesë të theksuar transparence në proceset e vendimmarrjes lidhur me burimet e financimit, planifikimin buxhetor, përdorimin e fondeve financiare, rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e personelit akademik. Gjendja paraqitet potencialisht kolaps përsa i përket cilësisë së kërkimit shkencor. Kuadri ligjor krijon mundësinë e kontroleve periodike në IAL-të, si për menaxhimin financiar, ashtu edhe për aspektin e ligjshmërisë.

Problematika

1. Moszbatimi i procedurave të rregullta të rekrutimit të stafit akademik;
2. Rritja e numrit të denoncimeve për korrupsion në procedurat e dhënies së titujve akademike, për abuzime, veprime korruptive, apo arbitrare;
3. Ndërgjegjësimi për shmangien e plagjiaturave në punimet shkencore, si rrezik për cilësinë, nivelin dhe ndershmërinë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor;
4. Mungesa e mekanizmave të kontrollit të brendshëm;
5. Mungesa e informimit sistematik dhe serioz të komunitetit universitar.

ZGJIDHJA

Për të adresuar problematikat si më sipër, Këshilli i Ministrive ka miratuar dy vendime:

- 1) Vendimin nr. 777, datë 26.12.2018 “Për kontrollin anti-plagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”;
- 2) Vendimin nr. 781, datë 26.12.2018 “Për garantimin e transparencës në Institucionet e Arsimit të Lartë”, të cilat përforcojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të IAL-ve.

Gjithashtu, do të miratohen:

1. Krijimi i një portali elektronik për ndjekjen e denoncimeve dhe ankimimeve të studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ të IAL-vë, në bazë të një dinamike në të cilën çdo sinjalizimi, kërkese, ankese apo denoncimi, do t’i jepet në çdo hap një përgjigje konkrete dhe informuese mbi shqyrtimin e saj deri në një vendim marrje finale;
2. Miratimi i procedurës nëpërmjet caktimit të afateve për shqyrtimin dhe vendim marrjen ndaj çdo denoncimi apo ankese;
3. Ngritja e grupeve të punës, rishikimi për Planin e Veprimit që përfshin procedurën, metodologjinë dhe instrumentet e vlerësimit për verifikimin e kriterëve normative dhe procedurave të punësimit të personelit akademik.

Marrja e masave të mësipërme do të realizohet brenda periudhës janar-mars 2019. Rezultatet e këtij procesi do t’i vihen në dispozicion komunitetit akademik të IAL-ve.

10

POLITIKAT FINANCIARE NË SHËRBIM TË CILËSISË SË KËRKIMIT SHKENCOR DHE KONKURRUESHMËRISË KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE TË IAL-VE

Situata aktuale dhe problematikat

Buxheti aktual për Arsimin është në masën e 3.1% të PBB-së (3.2% nëse përfshijmë Arsimin Profesional). Krahasimisht, mesatarja e vendeve të BE-së është 4.7% e PBB-së. Shpenzimet publike për arsimin e lartë në raport me PBB-në janë në masën e 0.2 pikë më të ulëta se mesatarja e BE-së. Shpenzimet në përgjithësi dhe investimet në veçanti janë rritur gradualisht përgjatë 5 viteve të fundit, por rritja nuk është reflektuar sa duhet në procesin e mësimdhënies dhe tek komuniteti akademik. Reforma arsimore e vitit 2015 i ka dhënë autonomi financiare të plotë IAL-vë, të cilat me vendimmarrje të përbashkët të Senateve dhe Bordeve të Administrimit përcaktojnë prioritetet dhe shpenzimet në bazë të tyre.

ZGJIDHJA

Përtej rritjes së subvencionimit për mbështetjen e studentëve (ulje efektive e tarifave), qeveria angazhohet për:

1. Rritjen e financimit për arsimin e lartë, duke synuar arritjen e mesatares së vendeve të rajonit deri në vitin 2023.
2. Përfundimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve mes IAL-ve dhe fakulteteve të tyre me ministritë e linjës, që mundësojnë bashkëpunimin në vazhdimësi me qëllim financimin e cilësisë së kërkimit shkencor, pajtimin e fakulteteve për ofrimin e konsulencës për projekte të institucioneve shtetërore dhe krijimin e mekanizmave sistematikë, për praktika mësimore, stazhe dhe punësim të studentëve, brenda mars 2019 dhe në vijim.
3. Integrimin e studentëve në procesin e parashikimit dhe transparencës së buxheteve të IAL-ve nëpërmjet evidentimit të nevojave përmes ndërveprimit në Platformën e Transparencës .
4. Shqyrtimi i mundësisë për rritjen e kontributit të sektorit privat në mbështetje të Arsimit të Lartë.

20% e fondit të përgjegjësisë sociale të korporatave nga kompanitë që gëzojnë kontrata koncesionare nga shteti shqiptar, të dedikohen për financimin e Arsimit të Lartë, sipas fushës apo vendodhjes së aktivitetit kryesor të koncesionit (termat negocohen në çdo kontratë)

11

PUNËSIMI I STUDENTËVE

Situata aktuale dhe problematikat

- Mospërputhje e numrit të të diplomuarve në programet e arsimit të lartë, me nevojat reale të tregut të punës vendas dhe atij të huaj;
- Mungesa e bashkërendimit të kurrikulave të arsimit të lartë me shoqatat përfaqësuese të biznesit vendas dhe të huaj;
- Ligji “Për nëpunësin civil” nuk krijon mekanizma për rekrutimin e studentëve të ekselencës në administratën shtetërore.

ZGJIDHJA

Është miratuar Vendimi nr. 766, datë 26.12.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të Shërbimit Civil për vitin 2019”.



Nëpërmjet kësaj VKM-je, për vitin 2019, pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e Shërbimit Civil, do të plotësohen me prioritet nga studentët e ekselencës, të cilët kanë përfunduar studime universitare në secilin prej cikleve të Arsimit të Lartë, duke filluar nga viti 2017, me mesatare 9.00-10.00, në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë Shqipërisë dhe Institucionet e akredituara të Arsimit të Lartë, publike apo private, në Republikën e Shqipërisë.

11

2. Është miratuar Vendimi nr. 812, datë 26.12.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për punësimin e studentëve të ekelencës në institucionet e administratës shtetërore, jashtë Shërbimit Civil, për vitin 2019".

Nëpërmjet kësaj VKM-je, për vitin 2019, pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive në institucionet e administratës shtetërore, jashtë Shërbimit Civil, do të plotësohen me prioritet nga studentët e ekelencës, të cilët kanë përfunduar studime universitare në secilin prej cikleve të Arsimit të Lartë, duke filluar nga viti 2017, me mesatare 9.00–10.00, në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë Shqipërisë dhe Institucionet e akredituara të Arsimit të Lartë, publike apo private, në Republikën e Shqipërisë.

Është ngritur portali punetembare.al dhe është shpallur thirrja e parë për shprehjen e interesit të studentëve të ekelencës, që duan të punësohen në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e Shërbimit Civil dhe jashtë tij. Thirrja e dytë do të shpallet brenda muajit gusht 2019.

3. Është miratuar Vendimi nr. 765, datë 26.12.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të ndryshuar.

Nëpërmjet kësaj VKM-je, e cila ndër të tjera parashikon edhe llojin e arsimit të kërkuar për çdo kategori dhe klasë, kriteri "Master Shkencor" zëvendësohet me "Master Shkencor apo Master Profesional, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike", duke zgjeruar kështu kategorinë e të diplomuarve që mund të aplikojnë për vendet vakante në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", të ndryshuar.

Nëpërmjet kësaj VKM-je, e cila do të miratohet brenda muajit maj 2019, do të rritet në 1,000 numri i të sapodiplomuarve (mosha 21-27 vjeç) që do të punësohen në administratën shtetërore, në nivel qendror dhe vendor dhe institucionet e tjera publike, nëpërmjet kontratave të përkohshme të praktikave të punës që zgjasin deri në 12 muaj.

5. Organizimi i panairëve të punës të dedikuara për IAL-të, në bashkëpunim me shoqatat përfaqësuese të sektorit privat vendas dhe të huaj.

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT

- PUNËSIM I 1000 STUDENTËVE EKSELENTË NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE PËR VITIN 2019
- GRUP PUNE PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KORPUSIT UNIVERSITAR TE TIRANES.
- KRIJOHET FONDI I SOLIDARITETIT: 20% E FONDIT TË PËRGJEGJËSISË SOCIALE NGA KONTRATAT KONCESIONARE PËR ARSIMIN E LARTË

Afati i realizimit

- Maj 2019

12

STAZHET DHE PRAKTIKAT PROFESIONALE TË STUDENTËVE

Situata aktuale

Pavarësisht se praktikat profesionale ofrohen si mundësi për studentët e diplomuar, ka ende shumë hapësira që duhen shfrytëzuar brenda vetë administratës publike. Përvoja me 'Programin Kombëtar i Praktikave të Punës', ku që nga shpallja e programit, para 3 vitesh, janë punësuar 1,740 studentë të diplomuar, përbën një bazë të mirë për ta shtrirë programin në mundësi më të mëdha. Nga ana tjetër ka nevojë për nxitjen dhe mbështetjen e studentëve për të zhvilluar praktikat profesionale edhe pranë kompanive private. Gjithashtu ka nevojë të ofrohet gjerësisht, edhe mundësia e stazhit profesional, veçanër-

ZGJIDHJA

11 VKM DHE 4 URDHËRA TË KRYEMINISTRIT SOT

1. VKM për praktikat profesionale, duke rritur numrin e vendeve të disponueshme dhe jo vetëm për studentët ekselentë, por me një proces përzgjedhjeje meritokratike. Përfshirja e ministrive, agjencive, por edhe shoqërive publike në varësi të Këshillit të Ministrave. Mundësia e shtrirjes së praktikave edhe në bashkitë dhe Institucionet e Pavarura.

2. Shpallja nga vetë institucionet publike, në çdo fillim viti, për vendet dhe mundësitë e zhvillimit të stazheve dhe rekrutimi nga vetë institucionet.

3. Mbështetja e ministrive për nxitjen e kompanive private në rritjen e mundësive për zhvillimin e praktikave profesionale dhe përmirësimin e stazheve.

FORCIMI I LIDHJES FAKULTETE - MINISTRI TË LINJËS PËR:

- FINANCIMIN NGA MINISTRITË PËR KËRKIM SHKENCOR
- FAKULTETET, SHËRBIME KONSULENCE NDAJ SHTETIT
- MEKANIZMA TË PRAKTIKAVE DHE STAZHEVE

Afati i realizimit

Mars 2019 fillimi i praktikave profesionale ne sektorin publik.

13

KAMPUSI UNIVERSITAR I TIRANËS

Situata aktuale

Mungesa e kampuseve universitare në Shqipëri është dëshmi e neglizhencës së tejzgjatur të udhëheqjes së IAL-ve, por edhe indiferencës së autoriteteve publike ndaj nevojave më thelbësore në përditshmërinë e jetës studentore, si zhvillimi i kurseve dhe aktiviteteve rinore dhe bashkëveprimi komunitar. Paraqitet domosdoshmëri konceptimi dhe ndërtimi i një kampusi universitar për Tiranën dhe Durrësin, i cili do të lidhte dy universitetet kryesore dhe hapësirën urbane më të madhe të vendit, sëbashku me infrastrukturën e duhur të transportit publik për studentët.

Problematika

1. Hapësira të pamjaftueshme në parkun imobiliar aktual;
2. Mungesa e një projekti vizionar për një kampus asociues të veprimtarive akademike dhe aktiviteteve të kohës së lirë, si dhe të kushteve të banimit dhe problemi i menaxhimit të projektit (IAL/ Bashkia Tiranë)

ZGJIDHJA

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, nr. 184, datë 26.12.2018, u ngrit Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) për vlerësimin e gjendjes dhe propozimin e masave për përmirësimin e infrastrukturës së Kampusit Universitar të Tiranës, me qëllim përshtatjen dhe zgjerimin e mjediseve universitare për ushtrimin e veprimtarive akademike e social-kulturore, krijimin e bibliotekës studentore dhe kryerjen e aktiviteteve të tjera në funksion të studentëve.

GNP është i ngarkuar që brenda datës 31 mars 2019 të paraqesë raportin përfundimtar për detyrat e ngarkuara, përfshirë një plan veprimi të detajuar me hapat që do të ndërmerren, me qëllim jetësimin e projektit për Kampusin Universitar të Tiranës.

Për jetësimin e projektit, përveç autoriteteve shtetërore përgjegjëse, janë ftuar për kontributin e tyre, përfaqësues të Bashkisë Tiranë, ekspertë të fushës, përfaqësues të qarqeve akademike, të shoqërisë civile dhe të studentëve.

